



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 287/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë , duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Dardanë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Dardanë, për shkak të vendosjes së banerit mbi rrugët te trafikut për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Dardanë kështu që subjektit politik Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1100(njëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 18. 10. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga LVV-ja, në të cilën theksohet se me datën 19 tetor 2013 rreth orës 14:00 në rrugën “ Skënderbeu “ në Dardanë anëtarë të subjektit politik AAK kane vendosur mbi rrugët publike banerin me fotografi te kandidatit nga rradhet e këtij subjekti Arif Hasanit. Me këtë rast sipas parashtruesit të ankesës subjekti politik AAK ka shkelur nenin 33 pika b) të LZP-së. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografimin si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, ora 12:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga AAK, në të cilën përgjigje mes të tjerash thekson se vendosja e banerit te kandidatit të AAK-së nuk është bere nga ana e strukturave te AAK-se. AAK-ja pretendon se vendosja e banerit mund te jete bere nga qytetare apo individ te pidentifikuar, AAK konfirmon qe me të pranuar njoftimin për vendosjen e banerit te kandidatit te AAK mbi rruget publike të trafikut, struktura menaxhuese e fushates, konkretisht Shtabi Zgjedhor për komunën e Dardanës ka bërë largimin e këtij baneri dhe ka kërkuar nga PZAP-i që të marrë për bazë veprimet e ndërruara nga AAK-së që janë të parapara me rregullën zgjedhore 11/2013 konkretisht neni 3 alinea 3.33.4 dhe 3.6.

Bashkangjitur me përgjigjen në ankesë AAK, ka dërguar fotot në të cilat shihet se janë larguar baneri me fotografi te kandidatit të saj nga vendi ku ka qenë i vendosur më parë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se baneri i kandidatit nga radhët e AAK-së, i vendosur mbi rrugët publike në komunën e Dardanës, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rënduese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik AAK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se konsiderohet se është e njoftuar me procesin zgjedhor dhe rregullat zgjedhore. Andaj vendosja e banerit të kandidatit të saj mbi rrugët publike e bënë përgjegjës këtë subjekt politik. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i, mori parasysh faktin se AAK, pas marrjes së kërkesës për përgjigjes në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime konkrete duke e larguar menjëherë banerin e kandidatit të saj nga vendi ku ka qenë i vendosur ai.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura konstaton se subjekti politik AAK-së ka shkelur nenin 4 paragrafi 1 pika "b" të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika b) të LZP-së, që ndalon vendosjen e njoftimeve, pllakateve, posterave apo të slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugët publike.

Andaj meqenëse baneri i kandidatit nga rradhët e AAK-së është i vendosur mbi rrugët publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të këtij subjekti që ka ndërmarr për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e tjera të ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 287/2013 më datën 25.10.2013.

Kryesuesi i Panelit  
**Nehat Idrizi**



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*